

RAPORTI

VJETOR

2019

Shtëpia e Pushimit, Durrës



Duke ju falënderuar, është kënaqësia ime, që në kuadër të transparencës t'ju prezantoj Raportin Vjetor të Punës së Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës për vitin 2019. Gjatë vitit, njësia ka vijuar përpjekjet në përmbushje të misionit të sajë me objekt të veprimtarisë së saj krijimin e kushteve për pushimin e punonjësve të Ministrisë së

Brendshme dhe të tjerë, gjatë sezonit të pushimeve dhe gjatë vitit si dhe shfrytëzimin e mjediseve të saj për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Institucioni organizohet dhe funksionon sipas parimit të ligjshmërisë, unitetit dhe hierarkisë, llogaridhënies, paanshmërisë, efektivitetit, dekoncentrimit, si dhe bashkëpunimit të brendshëm institucional.

Në këtë raport pasqyrohen masat afatshkurtra dhe afatmesme të ndërmarra për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të shfrytëzimit, projektet sipas prioriteteve të iniciuara gjatë këtij viti.

Gjithashtu, gjejnë pasqyrim treguesit kryesore të veprimtarisë, të arritura gjatë vitit 2019 në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike ndërinstitucionale dhe planeve konkrete të veprimit, si dhe në aspektin e zhvillimit të veprimtarisë dhe atë të ngjarjeve të ndodhura pas fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26.11.2019.

Gjen pasqyrim veprimtaria e strukturave si dhe prioritetet, objektivat dhe synimet tona për vitin 2020 e në vazhdim.

Vizioni ynë është krijimi i një zinxhiri shërbimesh cilësore me standarde bashkëkohore, konkurruese në treg, në përmbushje të misionit për të cilën funksion institucioni.

Në emër të stafit të Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, falënderoj Ministrinë e Brendshme, efektivat e Policisë së Shtetit si dhe familjarët e tyre për zgjedhjen që kanë bërë, duke pushuar në këtë institucion gjë që përmbush dhe misionin tonë, përmes bashkëveprimit të ngushtë me aparatën e Ministrisë së Brendshme.

Shpresoj që ky Raport të ndihmojë në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, përmes informimit dhe transparencës ndërinstitucionale.

ERMIR ALIÇKA

DREJTORI


TABELA E PËRMBAJTJES

I.	TREGUESIT KRYESOR TË REALIZUAR GJATË VITIT 2019	4
II.	SITUATA E KRIJUAR NGA FAKTORËT NATYROR (TËRMETI I DATËS 21.09.2019 DHE 26.11.2019), PASOJAT	8
III.	PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT, VITI 2020.....	9

TREGUESIT KRYESOR TË REALIZUAR GJATË VITIT 2019

Gjatë kësaj periudhe klientela kryesore ka qenë e përbërë nga funksionar dhe punonjës së Ministrisë së Brendshme. Ndërsa tarifa e një personi për një ditë pushimi në hotel vendoset me urdhër të përbashkët të dy Ministrive.

Gjatë vitit 2019 statistikat e shërbimit të hotelerisë tregojnë **shtimin e numrit të pushuesve efektivë të Ministrisë së Brendshme** nga 1,882 persona (e barasvlershme 18,115 ditë/qëndrimi) në vitin 2018 në 2,020 persona (e barasvlershme me 19,764 ditë/qëndrimi) në vitin 2019, ose 9 % më shumë që në total, rritje të ardhurash + 2,539,300 lekë .



Për këtë periudhë kohore gjithashtu **rritje të konsiderueshme kishte në të ardhurat dytësore** në zërin “biletë hyrje dhe çadra” ku u realizuan + 1,096,000 lekë më shumë (ose 315.3 %), në zërin “bar”, + 987,630 lekë më shumë (ose 278.8 %).

Një tjetër tregues i arritur gjatë vitit 2019 ka qenë **rritja e kënaqësisë së klientit** nëpërmjet përdorimit me efektivitet dhe efijçencë i të gjitha burimeve, ku klientët kanë lënë përshtypjet e tyre dhe janë shprehur pozitivisht për shërbimet e marra 95 % e pushuesve


Organizimi dhe menaxhimi i drejtë i burimeve, pasqyrimi i saktë i të dhënave të periudhës ushtrimore, si dhe regjistrimi i rregullt kronologjik i të gjithë transaksioneve për këtë periudhe, çoi në realizimin e treguesve të mëposhtëm:

- a) Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, i ndarë në dy periudha krijimi si më poshtë :

Aktiviteti	2018	2019	Diferenca	%
Aktiviteti kryesor (sezoni)	54,157,510	56,591,980	+ 2,434,470	104.5
Aktivitete te tjera (jashtë sezoni)	3,365,165	3,407,219	+42,054	101.3

Total	57,522,675	59,999,199	+2,476,524	104.3
-------	------------	------------	------------	-------

Të dhënat e tabelës së mësipërme do ti gjeni të shprehura grafikisht në tabelën vijuese.




a) Shpenzimet e vitit 2019

Në total shpenzimet me çelje buxhetore për vitin 2019, për njësinë tonë, janë miratuar fonde (buxhet dhe të ardhura) nga të cilat janë realizuar në masën 96%.

Më poshtë jepet pasqyra e fondeve të planifikuara dhe realizuara përkatësisht sipas zërave buxhetor, për vitin 2019.

Emërtimi	Plani	Realizimi	%
Paga & shpenzime personeli, sigurime shoqërore	29,570,000	27,994,617	95%
Blerje shpenzime operative	37,072,061	36,672,957	97%
Blerje pajisje, investime	4,560,000	4,560,000	100%



SITUATA E KRIJUAR NGA FAKTORËT NATYROR (TËRMETI I DATËS 21.09.2019 DHE 26.11.2019), PASOJAT

- a) Pas rënies së tërmetit të datës 21.09.2019, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit për akomodimin dhe trajtimin e personave të dëmtuar prej tij deri në muajin Mars 2020 u akomoduan dhe u trajtuan me ushqim rreth 130 persona.

Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme, Durrës, hipotekuar me certifikatë pronësie nr. kadastral 8518, numër pasurie 53/1 , ka në administrim 71,100 m² sipërfaqe totale nga të cilët 16,000 m² rërë dhe 6,250 m² sipërfaqe ndërtimi (4 hotele) .

- b) Tërmeti i datës 26.11.2019 shkaktoi dëme të konsiderueshme në aktivet e njësisë, duke çuar në humbje të kapaciteteve të shfrytëzimit, akomoduese (hotel) në masën 55.5% ose mungesë të ardhurash për buxhetin e shtetit 49,000,000 lekë në vit, të katër restoranteve të shërbimi me kapacitet 300 persona dhe një kuzhine gatimi.

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT, VITI 2020

Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme, Durrës, në kuadër të prioriteteve të Programit të Qeverisë Shqiptare 2017 – 2021, për Ministrinë e Brendshme; do të ketë për një periudhë pesë vjeçare prioritetet dhe objektivat të parashikuara në dokumentin strategjik 2020 -2023.

1. Përmirësimi i drejtimit dhe bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimitarisë, me objektiv;

- Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit në të gjitha nivelet për të siguruar një shërbim efektiv, eficient dhe ekonomik për të menaxhuar burimet dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.
- Forcimi i bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimitarisë së këtij shërbimi dhe punonjësit e tyre; organet e agjencitë e tjera publike dhe ato homologe të rajonit e më gjerë për të marrë eksperiencat më të mira.

2. Zhvillimi i standardeve bashkëkohore, për të krijuar një shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe parimeve, efektive, eficient dhe ekonomik, i kontrollueshëm, me objektiv:

- Sigurimi i burimeve të duhura (njerëzore, materiale e teknologjike), për të krijuar kushtet e nevojshme dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave

3. Pas tërmetit prioritetet kanë ndryshuar, drejtuesi i njësisë, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe ka informuar vazhdimisht lidhur me situatën në të cilën gjendet institucioni, nëpërmjet informacioneve javore dhe shkresave, si dhe ka hartuar një mastër plan me objektiva të adresuara dhe prioritete për vënien në eficiency, ku prioritet i parë për vitin 2020 do të jetë shtimi i kapaciteteve të shfrytëzimit me objektivin kryesor, të realizimit të misionit të njësisë *“Krijimi i kushteve sipas standardeve bashkëkohore për akomodimin dhe trajnimin e pushuesve të Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet:*

- Riparimit të godinës së hotelit nr.2, (49 dhoma me kapacitet 130 shtretër), sipas grupit të ekspertëve klasifikuar DS2. Kjo ndërhyrje do të bëhet në riparimin konstruktiv dhe arkitektonik dhe në përforcimet e nevojshme sipas një projekti, K.T.P në fuqi dhe sipas

EURO kod 6 dhe EURO kod 8-3 Kapitulli 4, sipas rregullave teknike, standardeve në fuqi dhe praktikave më të mira të ndërtimit.

- Ndërtimi i një godine të re, në truallin e hotelit të shembur, sipas praktikave më standarde bashkëkohore duke përfshirë të gjitha shërbimet me ambiente konkurruese në treg. Kjo godinë e re bashkëkohore do pritet të ketë edhe një impakt financiar për të ardhurat e Shtëpisë së Pushimit Durrës.